




# KU ËSHTË PROBLEMI ME PAGESAT PËR MBROJTJEN NË HAGË?

FAQE 4-5



Është bërë një dekadë prej kur Gjykata Speciale në Hagë nuk është emër i panjohur për qyte-

tarët e Kosovës. Megjithatë, në kohën e fundit, krahas rasteve gjyqësore, ajo po përmendet edhe

për kundërthëniet rreth pagesave që duhet t'i bëjë shteti për palën mbrojtëse. Kush ka të drejtë?

**PDK-ja DHE LDK-ja:  
IDEJA E KONSSENSUSIT  
NË KOSOVË KA  
EKZISTUAR, POR  
ËSHTË RRËNUAR NGJA  
VETËVENDOSJA** F. 3



**"TERREN I  
PASHKELUR  
KUSHTETUES",  
ANALISTËT: GJYKATA  
KUSHTETUESE  
NË KËRKIM TË  
ZGJIDHJES PËR  
NGËRÇIN POLITIK** F. 3



**GJERMANIA THOTË SE  
DO TË DËRGOJË SISTEME  
TË TJERA PATRIOT NË UKRAINË** F. 2

**KURTI: SERBIA PO VAZHDON  
PËRPJEKJET PËR DESTABILIZIM  
TË KOSOVËS** F. 7

**DUA LIPA MERR SHITETËSINË E  
KOSOVËS, PRESIDENTJA OSMANI:  
JEMI GJITHMONË KRENARË PËR TY** F. 3

## EKONOMI



**ODA AMERIKANE MIRËPRET  
HEQJEN E TARIFAVE DOGANORE  
PËR PRODUKTET AMERIKANE** F. 8

**SHBA-ja VENDOS TARIFA TREGTARE  
NDAJ DHJETËRA SHITETEVË,  
PËRFSHIRË ATO TË BALLKANIT** F. 8

## SPORT



**GJILANI NDAHET ME KUSHTRIM  
SHABANIN DHE ARAGO JAMALIN** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Gjermania thotë se do të dërgojë sisteme të tjera Patriot në Ukrainë

**BERLIN, 1 GUSHT** - Gjermania tha se së shpejti do ta nisë dërgimin e dy sistemeve të tjera të mbrojtjes ajrore Patriot në Ukrainë teksa Kievi po përballet me sulme ruse me dronë dhe raketa. Sistemet Patriot janë të prodhimit amerikan. Pas arritjes së një marrëveshjeje me Shtetet e Bashkuara, ushtria gjermane do të dorëzojë lëshues shtesë të sistemit Patriot gjatë ditëve në vijim dhe do të furnizojë me komponentë të tjerë në dy-tre muajt e ardhshëm, tha Ministria e Mbrojtjes. Në këmbim, Gjermania është pajtuar me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes që të jetë “shteti i parë” që do t’i marrë me përparësi sistemet Patriot të gjeneratës më të re. Berlini aktualisht ka nëntë sisteme Patriot, e që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës i ka dërguar Kievit tri sisteme të tilla.

Dy Patriotë të Gjermanisë momentalisht janë të stacionuar në juglindje të Polonisë, ndërkaj një tjetër po përdoret për t’i trajnuar ushtarët ukrainas. Gjermania është mbështetësja e dytë, pas ShBA-së, sa i përket ndihmës ushtarake për Ukrainën. Sistemet Patriot prodhohen nga kompania amerikane e mbrojtjes “Raytheon” dhe konsiderohen se janë një nga sistemet më efektive për rrëzimin e dronëve dhe raketave. Ministri i Mbrojtjes, Boris Pistorius, tha se njoftimi i së premtes “tregon edhe një herë se Gjermania është mbështetësja më e fuqishme e Ukrainës sa i përket mbrojtjes ajrore”. Njoftimi vjen teksa javën e kaluar presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se shteti i tij po punon të sigurojë



financimin për 10 sisteme Patriot pas marrëveshjes së arritur me ShBA-në, sipas së cilës, shtetet evropiane do të

blejnë armatim amerikan dhe më pas do t’ia japin Kievit. Përveç Gjermanisë, Norvegjia, Holanda, Danimarka dhe

Suedia kanë shprehur vullnet ta financojnë blerjen e këtij sistemi në bazë të marrëveshjes me Uashingtonin.

# Gjykata Evropiane: Italia duhet ta sigurojë rishikimin e vendimeve për azilkërkuesit nga “vendet e sigurta”

**STRASBURG, 1 GUSHT** - Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka marrë vendim të premten që vendet e Bashkimit Evropian mund t’i përshpejtojnë refuzimet e kërkesave të azilit për personat që janë nga vendet që konsiderohen të “sigurta”, por vetëm nëse ky përcaktim përmbush standardet strikte ligjore dhe u mundëson aplikantëve dhe gjykatave të kenë qasje dhe t’i kundërshtojnë provat mbështetëse. Në lëndën para gjykatës së BE-së përfshihen rastet e dy shtetasve të Bangladeshit, të cilët janë shpëtuar në det nga autoritetet italiane dhe janë transferuar në një qendër ndalimi në Shqipëri, nën protokollin mes Italisë dhe Shqipërisë. Rasti ka përfunduar në gjykatë pasi kërkesat e këtyre dy azilkërkuesve janë refuzuar, bazuar në përcaktimin e Italisë se Bangladeshi është shtet i



“sigurt”. Kushti i dytë i gjykatës parasheh që një shtet i origjinës mund të përcaktohet i “sigurt” nëse ofron mbrojtje adekuate për gjithë

popullsinë, përfshirë minoritetet. Në kuadër të përpjekjeve të qeverisë së krahut të djathtë në Romë për ta përshpejtuar

procesimin e kërkesave të azilkërkuesve, dhe për ta zvogëluar numrin e atyre që mund të hyjnë në shtet, Italia e ka përpiluar një listë të shteteve që i konsideron të sigurta për migrantët dhe të cilët, sipas saj, nuk kanë të drejtë ligjore për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare. Qeveria italiane synon t’i dërgojë migrantët nga shtetet e përcaktuara si të “sigurta” në një qendër ndalimi në Shqipëri, ku do të analizohen kërkesat për azil, përmes një procedure të përshpejtuar. Një gjykatë italiane që është marrë me lëndën e dy shtetasve të Bangladeshit ka kërkuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë të sqarojë nëse qeveria italiane mund të përpilojë një listë të shteteve të “sigurta” dhe nëse Roma duhet t’i deklarojë burimet e veta mbi të cilat e ka shpallur një vend të “sigurt” dhe

se çfarë kriteresh janë respektuar. Teksa qasja e së djathtës ekstreme sa shkon e pëlqehet më shumë në bllokun evropian me 27 vende anëtare, shumë shtete të BE-së janë duke miratuar qasje më të ashpër ndaj migrimit. Shumë kryeqytete evropiane janë duke shqyrtuar idenë që të krijohen qendra jashtë bllokut për azilkërkuesit të cilëve u është refuzuar azili, ose janë në proces. Megjithatë, përpjekja e Italisë për t’i procesuar kërkesat dhe për t’i transportuar migrantët në Shqipëri është duke u përballur me një mori pengesash ligjore. Zyra e kryeministres së Italisë, Giorgia Meloni, ka thënë të premten përmes se vendimi i gjykatës së BE-së është “befasues” dhe “dobëson politikat për ta luftuar imigrimin ilegal masiv dhe mbrojtjen e kufijve kombëtarë”.

## Dodiku dënohet me akt të formës së prerë për mosrespektim të vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë

**SARAJEVË, 1 GUSHT** - Millorad Dodik, presidenti i entitetit serb të Bosnjë-Hercegovinës, Republika Sërpska, është dënuar me vendim të formës së prerë të premten, më 1 gusht, për mosrespektim të vendimeve të Përfaqësuesit të Lartë, merr vesh Radio Evropa e Lirë. Aktgjykimin e ka shpallur trupi gjykues prej

tre anëtarësh, i përbërë nga Amella Huskiq, Vesna Jesenković dhe Hillmo Vučiniq. Ky trup gjykues e ka konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë të 26 shkurtit, me të cilin Milorad Dodik është dënuar me një vit burgim dhe ndalim prej gjashtë vjetësh për ushtrimin

e funksioneve politike. Kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës kanë ushtruar ankesë si ekipi juridik i Dodikut, ashtu edhe Prokuroria e Bosnjë-Hercegovinës. Prokuroria ka kërkuar ashpërsimin e dënimit me burg si dhe zgjatjen e

ndalimit për ushtrimin e funksioneve, ndërsa mbrojtja ka kërkuar anulimin e aktgjykimit. Dodiku është shpallur fajtor për nënshkrimin e dekretit për shpalljen e ligjeve që më herët ishin anuluar nga Përfaqësuesi i Lartë në Bosnjë-Hercegovinë, Christian Schmidt.



## Policia sekuestron pajisje për prodhimin e kriptovalutave në Zubin Potok

MITROVICË, 1 GUSHT - Më 31 korrik Policia e Kosovës në fshatin Qabër, komuna e Zubin Potokut, ka hasur në pajisje që shërbejnë për prodhimin e kriptovalutave. Në një objekt përcjellës të një

shtëpie, policia ka gjetur dhe sekuestruar 13 pllaka kompjuterike (riga) dhe pajisje të tjera përcjellëse që përdoren për prodhimin e kriptovalutave. Për sekuestrimin e këtyre pajisjeve

është njoftuar Dogana e Kosovës, e cila ka ndërmarrë hapat e mëtejshme ligjorë në lidhje me rastin. Policia e Kosovës u bënë thirrje qytetarëve të raportojnë çdo veprimtari të paligjshme në

numrin pa pagesë 192. Gjithashtu, policia ka bërë me dije se bashkëpunimi i qytetarëve është thelbësor për parandalimin, luftimin dhe zbulimin e veprimtarive të jashtëligjshme.



## PDK-ja DHE LDK-ja: IDEJA E KONSENSUSIT NË KOSOVË KA EKZISTUAR, POR ËSHTË RRËNUAR NGA VETËVENDOSJA

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 GUSHT - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka thënë se zgjedhja e kryeparlamentarit është privilegj i subjektit të parë, por përzgjedhja bëhet me shumicën e votave të Kuvendit. “Faleinderit për mundësinë e fjalës, sepse na është mohuar tash e sa muaj në Kuvendin e Kosovës. Më lejoni të shpreh mospajtimin tim me disa gjëra që u thanë. Shteti nuk është në pauzë. Çka po shohim është se kemi grushtshtet. Sot derisa po diskutojmë këtu, përkundër vendimit të Gjykatës Supreme, qeveria ka uzurpuar zyrat. Dhe nuk e them këtë fjalë me lehtësi. Për mua Kuvendi është vend ku kemi shpallur pavarësinë dhe kemi ndërtuar institucione me konsensus. Çka e ka definuar Kosovën ka qenë pikërisht ideja e konsensusit. Që nga Rambujeja e tutje të gjitha vendimet e mëdha janë miratuar si rezultat i pjekurisë

politike. Në Kosovë ideja e konsensusit është rrënuar pikërisht nga Lëvizja Vetëvendosje. Pra, ideja e konsensusit në Kosovë ka ekzistuar, është praktikuar, por është rrënuar nga Lëvizja Vetëvendosje. Ndonëse privilegji i takon subjektit të parë për zgjedhjen e kryeparlamentarit, përzgjedhja bëhet me shumicën e votave të Kuvendit të Republikës”, ka thënë Çitaku në takimin e organizuar nga Friedrich Ebert Stiftung (FES), Zyra në Prishtinë dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me temën “Kuvendi në pauzë, demokracia në sprovë: A është kompromisi dhe konsensusi zgjidhja?”. Ajo përmendi edhe pasojat për shkak të moskonstitimit të institucioneve. “Tash kemi humbur dhjetëra miliona euro për shkak të paparashikueshmërisë politike. Parashikueshmëria është kusht për zhvillim. Secili prej nesh e njeh nga një ndërmarrës të vogël për shkak të

papërbalueshmërisë së çmimit të energjisë elektrike”, ka deklaruar Çitaku. Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ngërçin politik e cilësoi grushtshtet, duke theksuar se të gjitha partitë kanë ofruar kompromise, por vetëm Vetëvendosja s’ka pranuar. “Nuk është që nuk hezitova, sepse nuk është se kemi çfarë të themi më ndryshe nga ajo që kemi thënë deri më tani. Nuk mendoj që është vetëm grushtshtet, por është vetëgrushtshtet. Partia në pushtet po dëshiron të jetë vetë në detyrë nga rezultatet që i ka marrë në zgjedhjet e 14 shkurtit. Në katër vjet mandat e kemi pasur përvojën që nuk e kemi pasur asnjëherë. Në legjislaturën e fundit nuk ka ndodhur që të pranohet as edhe një amendament nga partitë në opozitë. Ku është demokracia këtu? Që të gjitha partitë kemi ofruar kompromise, vetëm partia që e ka marrë shumicën e

votave nuk ka pranuar të bëjë kompromis. Ata insistojnë që Albulena Haxhiu është më e rëndësishme se çdo gjë”, ka thënë Bajrami. Deputeti i AAK-së, Lahi Brahima, ka thënë se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, dhe deputetët e tij kanë interes ta mbajnë këtë gjendje për të kapur çdo nivel të institucioneve. “Pse nuk duhet Albulena? U dhanë shumë arsye dhe kemi ofruar të gjithë emra alternativë, por interesi i LV-së nuk ka qenë formimi i Kuvendit, sepse nga 54 seanca, mbi 50 prej tyre kanë qenë jo të plota për shkak të mungesës së deputetëve të LV-së. Edhe nëse do t’i kishin numrat, gjithmonë mungonin dy ose tre deputetë të tyre. Kjo tregon qartë që nuk kanë qenë të interesuar. Aleanca që nga dita e parë ka propozuar zgjidhje”, ka thënë Brahima. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Nezir Kraki, ka thënë se kompromisi është i vetëkuptueshëm në politikë. Ai

ka thënë se nuk është e udhës të bllokohet Kosova me pasoja që mund të jenë edhe më të rënda, duke alokuar se partitë e tjera janë bllokuese. “Situata mund të ndryshojë, votat mund të ndryshojnë, edhe përqindjet. Prandaj, nuk më ka dalë e udhës mua që të bllokohet i gjithë procesi, të bllokohet Kosova, me pasoja që mund të jenë edhe më të rënda, ditëve ose javëve që vijnë. S’më ka dalë e udhës që kjo bllokadë të realizohet dhe të shkojë kaq gjatë mbi bazën e një apo dy pretendimeve që nuk kanë bazë”, ka thënë ai. Kraki ka theksuar se sistemi duhet të jetë totalisht funksional. “Dhe palët duhet t’i konfirmohen sistemit. Sepse situata mund të ndryshojë, edhe votat mund të ndryshojnë. Kompromisi duhet të jetë i vetëkuptueshëm në politikë, por kjo kërkon kulturë në politikë. Unë nuk jam që gjykata të na e transmetojë neve një të drejtë që të merremi vesh”, ka thënë deputeti i LV-së.

## Tahiri: Qeveria e re duhet t’i shpallë të pavlefshme të gjitha vendimet e qeverisë në detyrë

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ish-zëvendëskryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, ka bërë me dije se qeveria e re duhet t’i shpallë të pavlefshme të gjitha

vendimet e qeverisë në detyrë. Ajo ka vlerësuar se këto vendime janë antikushtetuese. Në “Facebook”, Tahiri ka shkruar se Kurti dhe LV-ja

kanë marrë mjaft para për fushatën e zgjedhjeve elektorale. “Qeveria e re që vjen domosdo - të shpallë të pavlefshme të gjitha vendimet e kësaj qeverie në

detyrë jokushtetuese të anulohen, edhe tenderët se LV-ja e Kurti morën mjaft para për fushatën e zgjedhjeve lokale”, ka shkruar Tahiri.





# KU ËSHTË PROBLEMI ME PAGESAT PËR MBROJTJEN NË HAGË?

Është bërë një dekadë prej kur Gjykata Speciale në Hagë nuk është emër i panjohur për qytetarët e Kosovës. Megjithatë, në kohën e fundit, krahas rasteve gjyqësore, ajo po përmendet edhe për kundërthëniet rreth pagesave që duhet t'i bëjë shteti për palën mbrojtëse. Kush ka të drejtë?

**PRISHTINË, 1 GUSHT** - Ministria e Drejtësisë në Kosovë ka thënë më 24 korrik se i ka ndarë në total rreth 33 milionë euro për mbrojtjen e të akuzuarve për krimet e supozuara të luftës në Kosovë në procesin gjyqësor që zhvillon Gjykata Speciale në Hagë. Më konkretisht, Gjykata i heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Kjo gjykatë - me gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë - është e themeluar me ligje të Kosovës në vitin 2015, por funksionon në Holandë. Ajo financohet kryesisht nga Bashkimi Evropian, me kontribute shtesë nga disa shtete të tjera, si Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia. Në dy vjetët e fundit ajo e ka pasur një buxhet rreth 100 milionë euro. Shpenzimet për ekipet mbrojtëse të të pandehurve i kryen kryesisht shteti i Kosovës.

Pavarësisht prej deklaratave të ministrisë, Organizata e Veteranëve të Luftës e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL e UÇK-së) ka thënë se e konsideron të turpshme vendosjen e “çmimeve tavan” për

tarifat ndaj ekipeve mbrojtëse në Hagë dhe ka kërkuar heqjen e menjëhershme të tyre. Rasti kryesor në Hagë po zhvillohet kundër ish-krerëve të UÇK-së, përkatësisht ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-deputetit të Kosovës, Rexhep Selimi. Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të cilat i kanë hedhur poshtë të katërtit.

Në dhjetor të vitit 2024 ndaj Thaçit është ngritur edhe një aktakuzë e dytë për pengim të drejtësisë.

## Për çfarë “çmimesh tavan” bëhet fjalë?

Sipas një udhëzimi administrativ të vitit 2024, Ministria e Drejtësisë i ka kategorizuar pagesat për avokatët mbrojtës me arsyetimin se “sistemi i pagesave duhet të kontribuojë në ruajtjen e një ekuilibri midis burimeve dhe mjeteve të të akuzuarit, në këtë rast shtetit të Kosovës”. Sipas këtij kategorizimi, shteti i Kosovës ndan deri në 110 000 euro në muaj për një avokat në fazën e gjykimit.

Ministrja në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë në një

intervistë për Radiotelevizionin Dukagjini, më 28 korrik, se në kategorinë e katërt - më të rëndën - bëjnë pjesë Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi. “Ajo që kemi bërë është që, duke parë se kemi pasur disa raste për pengim të drejtësisë, e kemi bërë ndryshimin përmes udhëzimit administrativ që të mos jetë dikush me mbështetje financiare të njëjtë sikurse ata që përballen me këto akuza (krime lufte), sepse nuk është e njëjta”.

Sipas udhëzimit të ri administrativ, nëse dikush në Gjykatën Speciale gjykohet për vepra penale, të cilat nuk kanë të bëjnë me krimet për të cilat është themeluar ajo, përfshirë: pengimin e drejtësisë, shkeljen e urdhrave të gjykatës, apo shkelje të tjera, atëherë shteti ofron deri në 5 000 euro në muaj për mbrojtjen.

“Kjo është bërë për ta dekurajuar këdo që ta dëmtojë këtë proces. Unë, personalisht, besoj që rastet e fundit më shumë i dëmtojnë ata sesa që u ndihmojnë”, ka deklaruar Haxhiu.

## A duhet të ketë kategorizime?

Amer Alija, hulumtues ligjor në Fondin për të Drejtën

Humanitare në Kosovë, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se duhet të ketë limite në shumën që ndan shteti për mbrojtje. “Nuk mund të shpenzohen pa limit resurset shtetërore”, ka thënë shkurt ai. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, ka thënë se shteti i Kosovës nuk duhet fajësuar për shumën e pagesave që bën në rastet që lidhen me pengim të drejtësisë, por që duhet të sigurojë mbrojtje efektive dhe të mos i kursejë mjetet kur bëhet fjalë për rastet e krimeve të luftës. “Qeveria do të duhej ta kishte një vizion shumë më të qartë dhe ta shihte mbrojtjen e të pandehurve si mbrojtje për vetë shtetin e Kosovës. Shteti do të duhej të analizonte, ta bënte një vlerësim se çfarë fiton Republika e Kosovës dhe sa është interesi i Republikës së Kosovës për mbrojtjen e luftës së UÇK-së dhe mbrojtjen e katër të pandehurve kryesorë në Hagë”. Sipas tij, procesi gjyqësor tani është në “periudhë kritike” për shkak të thirrjes së dëshmitarëve të profil të lartë në Hagë dhe angazhimit të madh të mbrojtjes, prandaj mund të ketë shpenzime më të mëdha. Në gusht të vitit të kaluar Fondacioni “Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit” u pati nisur letër krerëve

të shtetit, duke u kërkuar rritje të fondeve për nevojat e mbrojtjes juridike të ish-krerëve të UÇK-së, në të kundërtën rrezikohej largimi i avokatëve kryesorë. Por, sipas Miftarajt, “avokatët e kanë ditur qartë se sa do të jenë tarifat dhe sa do të zgjasë procesi”. “Problemi është te fakti që të pandehurit në Hagë, përveç ndihmës shtetërore, e kanë pasur Fondacionin që i ka mbështetur financiarisht, dhe të pandehurit ndoshta kanë pritur mbështetje më të madhe nga qytetarët, dhe kur kjo s'ka qenë e mjaftueshme, kanë mbetur mbrapa me pagesa për avokatë”.

Radio Evropa e Lirë nuk ka arritur të marrë një përgjigje nga mbrojtja, nëse pretendimet për largimet eventuale janë të vërteta. As Ministria e Drejtësisë nuk është përgjigjur në kërkesën e REL-it për më shumë hollësi rreth pagesave.

Gjykata Speciale është formuar jashtë shtetit, pas presionit të bashkësisë ndërkombëtare, për të garantuar proces gjyqësor të paanshëm. Droja nga mundësia e frikësimit të dëshmitarëve është një tjetër arsye pse gjykata e ka selinë në Holandë dhe jo në Kosovë. Deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë tentuar ta shpërbejnë atë më 2017, por pa sukses.

# 'TERREN I PASHKELUR KUSHTETUES', ANALISTËT: GJYKATA KUSHTETUESE NË KËRKIM TË ZGJIDHJES PËR NGËRÇIN POLITIK

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kosova gjendet në një situatë tejet të ndërlikuar, në një bllokadë institucionale, ku edhe pas 54 seancave nuk u arrit konstituimi i Kuvendit të Kosovës. Ky bllokim politik e ka detyruar Gjykatën Kushtetuese të ndërhyjë me një masë të përkohshme për ta vlerësuar kushtetutshmërinë e procesit dhe për të ofruar zgjidhje për dalje nga kriza. Në lidhje me këtë, Albert Krasniqi nga organizata "Demokracia Plus", në një prononcim për "Telegraf"-in, theksoi se Gjykata Kushtetuese ka para vetes një mundësi historike: t'i korrigjojë gabimet që ka bërë përbërja e kësaj Gjykate në aktgjykimin e vitit 2014 lidhur me interpretimin e grupit parlamentar. Sipas tij, në këtë drejtim, për t'i pamundësuar bllokatat prej subjektit politik që del i pari në zgjedhje dhe për t'i hapur rrugë konstituimit të Kuvendit, duhet t'u përgjigjet

disa pyetjeve thelbësore. "Se a ka abuzuar Avni Dehari me detyrën e tij si kryesues i seancës konstituive dhe cilat është procedura e zëvendësimit të kryesueseve që abuzojnë? A ka abuzuar LV-ja me të drejtën për propozim të kandidatit për kryetar të Kuvendit përmes bllokadave të qëllimshme që ka vendosur, dhe a humbet kjo e drejtë nëse me të abuzohet dhe nuk ushtrohet? Nëse po, kush e pason ushtrimin e kësaj të drejte?". Krasniqi, po ashtu, tha se gjykata duhet t'i sqarojë pasojat e tejkallimit të afatit prej 30-ditësh që ka vendosur për konstituim të Kuvendit. "Por, që në asnjë rrethanë, kjo nuk duhet të jetë marrja e mandatit të deputetëve aktual apo shpërndarje të Kuvendit për të shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme, pa u dhënë mundësia për të provuar nëse brenda legjislaturës aktual ekziston një

shumicë parlamentare", tha ai. Edhe Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka vlerësuar se vendi ndodhet në një terren të pashkelur kushtetues. Ai theksoi se mungesa e pasojave të qarta juridike nga ana e Gjykatës në të kaluarën ka krijuar një kulturë të papërgjegjshmërisë politike. "Është tejkaluar një afat kushtetues, që në vlerësimin tim është cenimi më serioz i rendit kushtetues që mund t'i bëhet procesit të formimit të institucioneve". Sipas Cakollit, shtyrja e afatit përtej kushtetutës, apo justifikimi i tij përmes sjelljeve jokushtetuese, rrezikon të kthehet në precedent të rrezikshëm, ku bllokatat politike bëhen mjet legjitim për ta penguar funksionimin e shtetit. Të dy ekspertët bien dakord se Gjykata Kushtetuese është në pozitën që të ndërtojë një precedent të ri kushtetues dhe të vendosë një standard të qartë që

ndalon abuzimin me vakuumet ligjore. Cakolli theksoi se: "Gjykata nuk ka nevojë ta shpërndajë Kuvendin, sepse ai nuk është konstituuar. Mjafton të konstatojë jo kushtetutshmëri të mandatit aktual dhe t'i hapë rrugë presidentes që të shpallë zgjedhje të reja". Sipas tij, Gjykata duhet të jetë garante e funksionimit të institucioneve dhe ta përforcojë parimin e sigurisë juridike, duke përjashtuar mundësinë e rikthimit të deputetëve të legjislaturës së kaluar si dhe të vendosë kufizime të qarta për sjellje politike që cenojnë rendin demokratik. Moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës pas zgjedhjeve të vitit 2025 ka nxjerrë në pah një krizë serioze politike dhe institucionale. Kosova ka mbajtur zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt dhe ende nuk ka Kuvend të konsoliduar të dalë nga zgjedhjet

e shkurtit. Pas betimit të deputetëve, procesi ka ngelur në votimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje, si partia me përqindjen më të lartë të votave që ka marrë, ka propozuar Albulena Haxhiun kryetare të Kuvendit dhe nuk po heqë dorë nga ky emër. Partitë e tjera, PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, kanë deklaruar se emri i Haxhiut është i papranueshëm për kryetare të Kuvendit pasi nuk është unifikues. PDK-ja dhe AAK-ja kanë kërkuar që LV-ja ta ndërrojë kandidatin dhe ta vë një emër të pranueshëm, ndërsa nga LDK-ja kanë deklaruar se nuk do të votojnë për asnjë kandidat të LDK-së. Pas mospajtimeve, kryesuesi Avni Dehari ka vënë në votim formimin e një Komisioni Zgjedhor që do të mundësonte votim të fshehtë për kryetarin e Kuvendit, por që në mungesë të kuorumit nuk ka kaluar.



## Të burgosurit në Prishtinë kontribuojnë në gjelbërimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës

PRISHTINË, 1 GUSHT - Shërbimi Korrektues i Kosovës vazhdon të zbatojë praktika që kontribuojnë në risocializimin e personave të privuar nga liria. Në angazhim të kësaj të burgosurit po kujdesen të kontribuojnë në gjelbërimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës. "Të dënuarit që janë pjesë e programeve të punës brenda institucionit kontribuojnë drejtpërdrejt në

mirëmbajtjen dhe gjelbërimin e hapësirave, duke krijuar një ambient të rregulluar, të pastër dhe estetik. Kopshti, i mbjellë me lule dekorative dhe bimësi të ndryshme, është rezultat i përkushtimit të tyre dhe një shembull konkret i përfitimeve që sjell angazhimi aktiv në aktivitete të dobishme", thuhet në njoftimin për medie. Sipas ShKK-së, përmes këtyre

veprimtarive të dënuarit jo vetëm që ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës brenda institucionit, por zhvillojnë aftësi praktike, ndjenjën e punës së ndershme dhe përgjegjësisë kolektive. Në njoftim thuhet se ky është një hap i rëndësishëm në funksion të përgatitjes për rikthimin e tyre në shoqëri si qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm.



# PROTESTA E 7 GUSHTIT: VIJA E KUQE KUNDËR DELEGJITIMIMIT TË UÇK-së DHE PËRBALLË PROJEKTIT GJEOPOLITIK SERBO-RUS PËR KRIMINALIZIMIN E LUFTËS SË DREJTË TË POPULLIT TË KOSOVËS



Prof. Dr. Fejzulla BERISHA  
(Ekspert i së drejtës publike)

## 1. Protesta e 7 gushtit - një akt i ndërgjegjes kolektive përballë një padrejtësie të strukturuar ndërkombëtare

Protesta qytetare e parashikuar për datën 7 gusht 2025 paraqet një akt të domosdoshëm rezistence qytetare dhe kombëtare përballë një padrejtësie të strukturuar në kuadër të mekanizmave ndërkombëtarë të drejtësisë, që në vend se të përballen me gjenocidin dhe krimet e luftës të kryera nga Serbia, janë shndërruar në mjete të instrumentalizuara për të delegjitimuar luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kjo protestë nuk është as mbështetje ndaj individëve specifikë të akuzuar, e as reagim emocional. Ajo është shprehje e vetëdijes kolektive për të mbrojtur të vërtetën historike, identitetin çlirimtar të shtetit të Kosovës, dhe parimet themelore të drejtës ndërkombëtare. Në këtë kuptim, ajo është një mburojë qytetare kundër përpjekjes për të rishkruar historinë dhe për të kriminalizuar vetë konceptin e lirisë dhe të drejtës për vetëvendosje.

## 2. Kriminalizimi i UÇK-së - një strategji hibride serbo-ruse përmes dezinformimit, fabrikimeve dhe instrumentalizimit të drejtësisë ndërkombëtare

Që nga fillimi i viteve 2000, e veçanërisht pas krijimit të Dhomave të Specializuara të

Kosovës në Hagë (2015), është konstatuar një paradigmë e rrezikshme e cila tenton të vendosë UÇK-në si subjekt të përgjegjësisë penale ndërkombëtare, në një kohë kur krimet e shtetit serb në Kosovë nuk kanë marrë trajtimin e duhur në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtësisë.

Kjo strategji përfshin disa komponentë kryesorë: Shërbimi sekret serb (BIA) ka prodhuar dhe shpërndarë dosje të fabrikuara, që janë kanalizuar nëpërmjet rrjeteve të infiltrimit diplomatik dhe institucional në misionet ndërkombëtare (UNMIK, EULEX), për të ndërtuar akuza ndaj figurave kyçe të luftës çlirimtare; Diplomacia hibride serbo-ruse, që përmes partneriteteve me qarqe pro-serbe në institucionet evropiane, ka përhapur narrativën e “krimeve të dyanshme” për të relativizuar përgjegjësinë ekskluzive të shtetit agresor; Infiltrimi dhe ndikimi në sistemin e Dhomave të Specializuara, që ndonëse janë formalisht institucione të Republikës së Kosovës, operojnë me logjikë të theksuar selektive dhe penalizuese ndaj njëanshmërisë politike e historike.

Këto dosje janë përdorur për të ngritur aktakuza të cilat mbështeten në dëshmitarë të kontestueshëm, shpesh të frikësuar apo të manipuluar, dhe pa verifikim të besueshëm nga mekanizmat e standardizuar të drejtësisë ndërkombëtare.

## 3. Dështimi sistematik i drejtësisë ndërkombëtare për të ndëshkuar krimet e Serbisë dhe për të adresuar gjenocidin në Kosovë

Sipas të dhënave të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), mbi 1,600 shqiptarë të Kosovës vazhdojnë të konsiderohen të zhdukur si rezultat i operacioneve të organizuara nga strukturat shtetërore të Serbisë. Megjithatë, drejtësia ndërkombëtare ka

dështuar në mënyrë sistematike të ndëshkojë drejtuesit politikë dhe ushtarakë të përgjegjshëm për këto krime.

Krimet e dokumentuara nga Tribunalet e Hagës përfshijnë: Masakra e Reçakut (15 janar 1999), me 45 civilë të vrarë; Masakra e Krushës së Madhe (mars 1999), me mbi 200 viktima; Krime në Mejë, Izbicë, Suharekë, Çikatovë e Vjetër, e të tjera; Asnjë nga zyrtarët e lartë serbë si Ivica Dačić apo Nebojša Pavković nuk është përballur me drejtësi për përgjegjësitë e tyre direkte apo indirekte në këto krime.

Në vend që të veprojë për të ndëshkuar këto akte gjenocidale, drejtësia ndërkombëtare ka zgjedhur rrugën e revizionizmit historik dhe amnistimit gjeopolitik të Serbisë, duke përqaftuar një qasje që e barazon viktimën me agresorin.

## 4. Protesta - e drejtë kushtetuese dhe detyrim qytetar për mbrojtjen e së vërtetës dhe të drejtësisë

Protesta e 7 gushtit gëzon një bazë të fuqishme juridike dhe kushtetuese. Sipas nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo qytetar ka të drejtë të shprehë mendimin dhe të protestojë në mënyrë paqësore. Kjo e drejtë është e garantuar gjithashtu nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 11) dhe standardet universale të së drejtës ndërkombëtare.

Në këtë frymë, protesta është një akt legjitim politik, moral dhe kushtetues, që buron jo vetëm nga nevoja për të shprehur pakënaqësi, por nga përgjegjësia kolektive për të mbrojtur themelin mbi të cilin është ndërtuar shteti modern i Kosovës.

Në dritën e nenit 1 të Kartës së OKB-së dhe Protokollit Shtesë I të Konventave të Gjenevës (1977), lufta për çlirim kombëtar është e njohur si një formë legjitime rezistence kundër okupimit të huaj dhe shtypjes sistematike. UÇK-ja, si një forcë e organizuar për çlirim kombëtar,



nuk mund dhe nuk duhet të barazohet me aktorët shtetërorë që kanë kryer krime sistematike të natyrës gjenocidale.

## 5. Delegjitimimi i çlirimtarëve - strategji për zhbërjen e shtetit të Kosovës dhe për relativizimin e agresionit serb

Projekti për kriminalizimin e UÇK-së nuk ka si objektiv vetëm goditjen e individëve, por është pjesë e një strategjie më të thellë që synon të: Delegjitimojë baza morale dhe historike të shtetësisë së Kosovës; krijojë një vakuum në identitetin politik e institucional të Republikës; Dobësojë aleancën strategjike me Perëndimin, duke e paraqitur Kosovën si një subjekt jo të besueshëm ndërkombëtarisht; dhe të hapë rrugën për një rikthim të ndikimit serbo-rus në Ballkanin Perëndimor, përmes metodave të luftës hibride. Heshtja institucionale përballë këtyre përpjekjeve krijon një precedent të rrezikshëm për të ardhmen e shtetësisë, demokracisë dhe sovranitetit të Kosovës. Në këtë kontekst,

mosreagimi nuk është neutralitet - është bashkëfajësi me padrejtësinë.

## 6. Protesta e 7 gushtit - thirrje për drejtësi, dinjitet dhe mbrojtje të themeleve të Republikës

Protesta e 7 gushtit përbën një vijë të kuqe morale, historike, kushtetuese dhe diplomatike, që ndan drejtësinë nga manipulimi, të vërtetën nga propaganda, dhe shtetin nga nënshtrimi.

Ajo është: Zëri i atyre që luftuan për jetë, dinjitet dhe liri, e jo për pushtet apo krim; Reagim kundër kriminalizimit të së drejtës për liri, që përfaqësohet përmes UÇK-së; Kujtesë kolektive për një popull që refuzon të gjykohej nga standardet e imponuara të drejtësisë selektive dhe politike. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është themeli moral dhe politik i Republikës së Kosovës. Kush hesht sot përballë delegjitimitit të saj, nesër do të heshtë përballë mohimit të vetë shtetit. Liria nuk është krim. Liria është sakrificë. Dhe liria është e drejtë ndërkombëtare.

## Maqedonci nderoi me pjesëmarrje “Stuhinë” në Kroaci në shënimin e 30-vjetorit

Prishtinë, 1 gusht - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, i ftuar nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Mbrojtjes i Kroacisë, Ivan Anušić, nderoi paradën e Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë, duke shënuar 30-vjetorin e Operacionit “Stuhia” (“Oluja”), një çast vendimtar për çlirimin dhe pavarësinë e Kroacisë. Ministri Maqedonci theksoi se luftërat në Jugosllavi gjatë dekadës së fundit të shekullit XX

e kanë përafruar popullin shqiptar me popullin kroat përballë politikave hegjemoniste dhe kriminale të Serbisë.

Ministri Maqedonci theksoi se “Kosova dhe Kroacia janë dy shtete aleate që angazhohen për paqe në rajon, sepse shqiptarët dhe kroatët janë dy popuj miq, që besojnë te demokracia dhe fqinjësia e mirë. Ne nuk e harrojmë të kaluarën, andaj do të angazhohemi së bashku që ajo të mos përsëritet”, u shpreh



ministri. Operacioni “Stuhia” ishte një

operacion i ushtrisë kroate i zhvilluar nga 4 deri më 7 gusht të

vitit 1995 kundër trupave të kuazi-shtetit (shtet i vetshpallur), Republikë Serbe e Krajines. Luftimet vazhduan deri më 14 gusht. Operacioni “Stuhia” ishte vendimtar në Luftën Kroate për Pavarësi (1991-1995). Shumë shqiptarë ishin pjesë e këtij operacioni dhe luftuan krah për krah me ushtarët kroatë, duke i kontribuar luftës për çlirimin e popullit kroat dhe pavarësimin të Kroacisë nga Jugosllavia e cila ishte e dominuar nga Serbia.

## Dua Lipa merr shtetësinë e Kosovës, presidentja Osmani: Jemi gjithmonë krenarë për ty

PRISHTINË, 1 GUSHT - Një natë para nisjes së Festivalit "Sunny Hill" në Prishtinë, superylli i muzikës, Dua Lipa, është pritur nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Këngëtares me famë ndërkombëtare dhe që ka rrëmbyer shumë zemra, me dekret presidencial, i është dhënë shtetësia e Republikës së Kosovës.

Presidentja e cilësoi nder të veçantë që me dekret presidencial i dha shtetësinë e

Republikës së Kosovës, Dua Lipës, një prej personaliteteve më të rëndësishme kulturore dhe artistike në historinë e vendit. "Nder i veçantë që sot, me dekret presidencial, t'ia jap shtetësinë e Republikës së Kosovës, Dua Lipës, një prej personaliteteve më të rëndësishme kulturore dhe artistike në historinë e vendit tonë. Dua dhe Kosova kanë qenë gjithmonë të pandashme. Ajo ka qenë dhe vazhdon të jetë

një nga zërat më të fuqishëm në skenat më të mëdha të botës, duke bërë histori me të arriturat e saj dhe duke u shndërruar në inspirim për miliona njerëz anekënd globit. Mirënjohja jonë është e pafund për gjithçka që Dua ka bërë dhe vazhdon të bëjë për Kosovën, për rininë tonë, për artin tonë dhe për imazhin ndërkombëtar të vendit tonë. Dua, Kosova është gjithmonë krenare me ty!", ka thënë Osmani.



## KURTI: SERBIA PO VAZHDON PËRPPJEKJET PËR DESTABILIZIM TË KOSOVËS

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë të mbajtur të premten, ka marrë disa vendime, duke nisur nga ato që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punës së institucioneve shtetërore si emërimi i Këshillit Statistikor, emërimi i drejtorit të përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike, si dhe emërimi i drejtorit ekzekutiv për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. "Të gjitha këto procese kanë filluar gjatë periudhës kur qeveria jonë ka pasur mandat të plotë dhe sot janë në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Qeveri. Po ashtu, do të ndajmë 40 mijë euro mbështetje për familjet e dy zjarrfikësve, Sefadin Osmanaj dhe Kaqun Lima, të cilët humbën jetën në krye të detyrës në vitin 2024, respektivisht në vitin 2025. Pra, 20 mijë euro për familjen Osmanaj dhe 20 mijë euro për familjen Lima. Vetëmohimi dhe përkushtimi profesional i Sefadin Osmanajt dhe Kaqun Limës ndaj detyrës fisnike të zjarrfikësit do të kujtohen gjithmonë, me mirënjohjen më



të thellë", ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se derisa Kosova po angazhohet për forcimin e partneriteteve me shtetet aleate, demokratike e paqedashëse, "fqinja jonë agresive, Serbia, po i vazhdon përpjekjet për destabilizim të

vendit tonë". "Mirëpo institucionet e inteligjencës dhe sigurisë së Republikës së Kosovës janë duke u kundërvënë suksesshëm ndaj këtyre përpjekjeve. Këtu përfshihen edhe arrestimet e personave përgjegjës me

dëshmi për aktivitetet e tyre kundër Kosovës - sikurse rastet e: Bojan Jevtiq - toger në Policinë e Kosovës, i arrestuar me datë 17 korrik 2025, mbi dyshime të bazuara për veprimtari spiunazhi në Republikën e Kosovës, për interesa të Agjencisë për Siguri dhe Informim (BIA), me synim rrezikimin e sigurisë në përgjithësi dhe operacionet e Policisë së Kosovës në veçanti; dhe Igor Popoviq - ndihmësdrejtor në të ashtuquajturën 'Zyra për Kosovë' në Qeverinë e Serbisë, i arrestuar me datë 18 korrik 2025, për nxitje të përçarjes dhe mos durimit ndëretnik. Në lidhje me këtë të fundit, institucionet tona, kanë siguruar dëshmi për lidhjet e tij me Agjencinë për Siguri dhe Informim (BIA) dhe ushtrimin e aktiviteteve në dobi të saj. Ndër to përfshihen: Incizimin ilegal të bisedave të datës 17 shtator 2020 që janë zhvilluar në Bruksel, në objektin e Bashkimit Evropian, në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi; pastaj përpjekje për pengim dhe sabotim të drejtësisë; dhe aktivitete tjera që cenojnë sigurinë kombëtare të vendit", ka thënë Kurti, duke shtuar se rasti i fundit ku dëshmohet autoincizimi ilegal dhe i fshehtë i bisedave në

Bruksel, është rast jashtëzakonisht serioz që shpërfaq në një formë që nuk e kanë hasur më herët të qasjes sistematike, destruktive, minuese dhe sabotuese të Serbisë, në raport me palët, ndërmjetësuesin dhe vetë procesin e ndërmjetësuar nga Brukseli.

"Gjithashtu, në këtë adresim, më lejoni që të shprehim shqetësimin e thellë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për krizën humanitare në Gaza. Sikurse kemi bërë edhe në të kaluarën, ne i dënojmë sulmet që rezultojnë me vdekje dhe lëndim të civilëve, veçanërisht të fëmijëve - të cilët po përballen me pasoja të rënda pavarësisht faktit që nuk kanë asnjë përgjegjësi mbi konfliktin dhe situatën. Qeveria jonë tashmë ka ndarë gjysmë milionë euro nga buxheti i saj si mbështetje për popullin palestinez në Gaza. Ne e mbështesim çdo përpjekje të partnerëve tanë për të arritur një armëpushim të menjëhershëm, që do të krijonte mundësitë për dërgimin e rregullt dhe të mjaftueshëm të ndihmave, lirin e pengjeve dhe arritjen e një zgjidhjeje afatgjatë dhe të qëndrueshme midis izraelitëve dhe palestinezëve", ka thënë Kurti.

## Policia dhe Prokuroria: Në liqenin e Ujmanit nuk ka tela të lidhur në energji elektrike

PRISHTINË, 1 GUSHT - Policia e Kosovës dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë kanë bërë me dije se në liqenin e Ujmanit nuk ekzistojnë tela të lidhur në energji elektrike dhe nuk paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve.

Në një komunikatë të lëshuar për medie nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë dhe Policia e Kosovës është thënë se hetimet kanë nisur pas deklarimeve të kryetarit të Shoqatës së Peshkatarëve të Kosovës, i cili ka pretenduar se më 30 korrik në liqenin e Ujmanit ka vërejtur tela elektrikë të zhytur në ujë, të

cilët, sipas tij, rrezikojnë njerëzit.

Policia ka thënë se ka pranuar edhe një video lidhur me këtë rast dhe e ka intervistuar personin në fjalë në cilësinë e dëshmitarit, i cili ka thënë se "gjatë një aksioni për largimin e varkave pa leje, ka vërejtur tela në ujë dhe se, nëse aktivizohen, mund të paraqesin rrezik për qytetarët". "Policia e Kosovës apelon te qytetarët që të mos shqetësohen dhe të mos ndihen të frikësuar, pasi çdo rast i dyshimtë do të trajtohet me kujdes dhe seriozitet maksimal", ka thënë policia, duke përmendur se njësitet

policore kryejnë vazhdimisht patrullime në liqenin e Ujmanit. Sipas komunikatës, Prokuroria ka vlerësuar se nuk ekzistojnë elementë të ndonjë veprë penale.

Liqeni i Ujmanit gjendet në Zubin Potok, një nga katër komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Më herët gjatë javës, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) e ka gjetur trupin e pajetë të Rrahim Latifit, 33-vjeçar, në këtë liqen, i cili dyshohet se ka kërcyer nga ura në ujë. FSK-ja ka thënë se operacioni është zhvilluar në koordinim me Policinë e Kosovës, misionin e NATO-s në



Kosovë (KFOR) dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave. Trupi u është

dorëzuar autoriteteve për procedurat e mëtejme hetimore.

# SHBA VENDOS TARIFA TREGTARE NDAJ DHJETËRA SHTETEVE, PËRFSHIRË ATO TË BALLKANIT

**PRISHTINË, 1 GUSHT** - Presidenti amerikan Donald Trump i ka paraqitur të enjten vonë shkallët e reja tarifore për dhjetëra partnerë tregtarë të Shteteve të Bashkuara. Ai ka thënë se tarifat ndaj 69 vendeve do të hyjnë në fuqi më 7 gusht.

Në vendimin e publikuar nga Shtëpia e Bardhë më 31 korrik është thënë se mallrat e çdo vendi partner tregtar që nuk përfshihen në aneksin e urdhrit do të jenë subjekt i taksës prej 10-përqindësh bazuar në urdhrin ekzekutiv të prillit.

Në atë urdhër Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi ishin goditur me taksë bazë prej 10-përqindësh. Sipas modifikimeve të fundit, vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë goditur me tarifa më të larta: Maqedonia e Veriut 15 për qind, Bosnjë-Hercegovina 30 për qind dhe Serbia 35 për qind.

Në nivel botëror, vendet më të goditura nga tarifat janë Siria, Laosi dhe Mianmari me tarifa që shkojnë deri në 41 për qind.

Afati i 7 gushtit nuk vlen vetëm për Kanadanë, pasi tarifa prej 35-përqindësh në mallrat e saj ka hyrë në fuqi menjëherë. Kryeministri kanadez Mark Carney është shprehur i zhgënjyer, ndonëse autoritetet kanadeze kanë përmendur se shumica e mallrave nuk preken nga vendimi për shkak të marrëveshjes tregtare ShBA - Meksikë - Kanada.

Trumpi e ka bërë këtë njoftim pak para se të skadonte afati 90-ditor që kishte vendosur në prill për pezullim të tarifave që kishte paraqitur atëherë, me qëllim të ofrimit të hapësirës për të negociuar me partnerët tregtarë. Përmes këtyre masave ai synon ta transformojë sistemin tregtar botëror të cilin e konsideron të padrejtë ndaj ShBA-së. Disa vende, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe Bashkimin Evropian, kanë arritur marrëveshje tregtare.

Administrata e tij ka thënë se pritet të arrihen edhe marrëveshje të tjera tregtare në ditët në vijim.

Tarifat nënkuptojnë që kompanitë, të cilat dërgojnë mallra në Shtetet e Bashkuara, do të duhet t'i paguajnë taksë qeverisë amerikane.

Ekspertët besojnë se këto kompani mund t'i bartin shpenzimet te konsumatorët dhe për pasojë mund të rriten çmimet e mallrave.

Kur tarifat ishin përmendur për herë të parë në prill, ekspertët në Kosovë patën vlerësuar se ato do të kenë shumë ndikim për shkak të varësisë së madhe nga importet.

Kosova aktualisht ka një taksë prej 10 % për mallrat e importuara nga ShBA-ja.

Në fillim të prillit, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kërkuar nga Qeveria në detyrë e Kosovës pezullimin e saj, por



taksa është ende në fuqi.

Osmani pati thënë se zyra e saj e ka bërë gati një ligj që do të mundësonte heqjen e tarifave prej 10-përqindësh ndaj mallrave amerikane, por se për miratimin e këtij ligji duhet fillimisht të konstituohet Kuvendi i ri - diçka që nuk ka ndodhur ende, as pas mbi 50 tentimesh.

Organizatata ekonomike në Kosovë kanë treguar se nga viti 2019 ka nisur rritja e eksporteve të përgjithshme të Kosovës në ShBA.

Këtë e tregojnë edhe të dhënat e Doganës së Kosovës, sipas të cilave, vlera e tyre në vitin 2019 ishte tre milionë euro, ndërsa tre vjet më vonë arriti në mbi 131 milionë (2022).

Produktet që i eksporton Kosova në ShBA përfshijnë: ushqime, lëngje, tekstil, dyshekë, por dhe prodhime nga druri dhe plastika.

Ditë më parë Ambasada Amerikane në Prishtinë i ka thënë Radios Evropa e Lirë se Shtetet e Bashkuara besojnë se ekzistojnë mundësi të

rëndësishme për bashkëpunim ekonomik me Kosovën në disa sektorë strategjikë dhe se heqja e barrierave tregtare do t'i forconte më tej këto lidhje. “Ne i inkurajojmë sektorët publikë dhe privatë në Kosovë të vazhdojnë të kërkojnë mundësi ekonomike dhe investime në tregun amerikan dhe që qeveria të promovojë një mjedis transparent dhe të qëndrueshëm për bizneset amerikane që kërkojnë të zgjerohen në Kosovë”, është thënë në përgjigje.

## Kosova heq tarifën ndaj mallrave amerikane

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije të premtën se Kosova do ta heqë tarifën doganore ekzistuese prej 10-përqindësh në mallrat amerikane. “Tani e tutje të gjitha produktet me orgjinë nga Shtetet e Bashkuara do të kenë tarifë 0 për qind kur të hyjnë në vendin tonë. Kosova i mirëpret

produktet amerikane në tregun e saj dhe besojmë fuqishëm se kjo do të ndikojë në rritjen e këmbimit tregtar dhe shtimin e investimeve”, ka thënë Kurti gjatë mbledhjes së qeverisë. Kurti ka thënë se përmes këtij hapi dëshmonen marrëdhëniet e mira në mes të dy vendeve dhe tregohet se Kosova dëshiron të

ketë marrëveshje për tregti të lirë me Shtetet e Bashkuara. Vendimi i Kurtit ka ardhur një ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump i ka paraqitur tarifat e reja ndaj 69 vendeve me të cilat bën tregti ShBA-ja, me arsyetimin se ato kanë qenë të padrejta ndaj ekonomisë amerikane.



## Oda Amerikane mirëpret heqjen e tarifave doganore për produktet amerikane

**PRISHTINË, 1 GUSHT** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mirëpret vendimin e Qeverisë së Kosovës për t'i hequr tarifat doganore për të gjitha mallrat e importuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ky hap i rëndësishëm pasqyron një demonstrim të fortë dhe strategjik për ta avancuar bashkëpunimin ekonomik me ShBA-në, partnerin më të ngushtë politik dhe ekonomik që ka Republika e Kosovës.

Sipas njoftimit, vendimi është edhe përgjigje në thirrjen e Odës Ekonomike Amerikane të

para disa muajve, e cila rekomandonte një vendim të njëanshëm preferencial tregtar, për ta nxitur tregtinë dypalëshe si dhe për ta pozicionuar Kosovën në mënyrë të favorshme për një Marrëveshje të ardhshme të Tregtisë së Lirë me Shtetet e Bashkuara. “Duke hequr tarifat doganore për mallrat amerikane, Kosova jo vetëm që forcon atraktivitetin e saj si një partner i besueshëm dhe i hapur për bizneset amerikane, por gjithashtu krijon mundësi të reja për konsumatorët dhe kompanitë vendase për plasim më të

madh të produkteve cilësore amerikane, e me çmime më konkurruese. Në të njëjtën kohë, kjo masë hap rrugën për rritjen e flukseve tregtare, shkëmbimin teknologjik dhe investimet në sektorët kryesorë, të cilat do të përfitojnë ekonomitë e të dy vendeve”, thuhet në njoftim.

Më tej, thuhet se Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë e përgëzon Qeverinë e Kosovës për marrjen e këtij vendimi, duke shprehur gatishmërinë për promovimin e mundësive të shkëmbimit më të madh tregtar në të ardhmen.



“Ne mbetemi të përkushtuar për të promovuar politika që rrisin qasjen në treg, forcojnë lidhjet ekonomike dhe ofrojnë

përfitime afatgjata për bizneset dhe konsumatorët si në Kosovë ashtu edhe ata në Shtetet e Bashkuara”, thuhet në njoftim.

# ‘LUFTA’ PËR MENDJEN. PROPAGANDA SI FISHEK DHE MEDIA SI ARMË

Kushdo që mendon se propaganda është diçka që i përket të kaluarës, apo vetëm regjimeve totalitare, me siguri do të duhet të rishikojë disa ide fikse që mund të ketë krijuar në kokë.

Propaganda sot nuk është domosdoshmërisht një poster i madh në mur që lavdëron liderin suprem, as një film propagandistik bardhë e zi nga koha e Luftës së Ftohtë. Sot, propagandën e shohim të jetojë ngjitur me ne, çdo ditë, brenda ekranit të smartfonit, në një titull të bujshëm lajmesh, apo në një debat televiziv, ku e vërteta humbet mes zhurmës dhe spektaklit bajat.

Shumëkush e identifikon propagandën me gënjeshtëri e thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, por nuk është kështu. Sepse ajo është më e sofistikuar dhe shumë më efektive, seç ka qenë ndonjëherë.

Propaganda e kohëve tona nuk kërkon domosdoshmërisht të bindë qytetarin mbi një gënjeshtëri të vetme. Shpesh mjafton thjesht ta ngatërrojë, t'i krijojë dyshime dhe të relativizojë gjithçka.


Po cilat janë disa prej teknikave që përdoren zakonisht për të kontrolluar mendimin publik dhe për të “ngatërruar” mendime e perceptime?

## Përsëritja pa pushim e mesazhit, e kthyer pothuaj në fiksion

Kush e ka vënë re se sa shpesh një mesazh, sado absurd, përsëritet pa pushim? NUK ndodh rastësisht, por bazohet në Psikologji. Është vërtetuar qartë nga studime psikologjike, se përsëritja e vazhdueshme e një ideje rrit besueshmërinë e saj, pavarësisht nëse është apo jo e vërtetë. Nëse të përsëritet në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpeshtë, që fjala vjen, “sot ekonomia është më mirë se kurrë”, pas njëfarë kohe ti mund të fillosh të besosh që ndoshta kjo është e vërteta.

## Shpërqëndrimi i njerëzve përmes lajmeve të pavlera

Një nga teknikat më të përdorura është prodhimi i lajmeve të parëndësishme, por me potencial për të bërë bujë. Mediat e interesuara dhe të porositura, hedhin mbi “tavolinën” e lexuesve dhe shikuesve histori personale, thashethemnaja politike apo për të ashtuquajturit VIP-a, me qëllim që të largojnë vëmendjen. Ky bombardim i përditshëm me “pseudon-gjarje” bën që qytetari të harrojë çfarë është e rëndësishme dhe të harxhojë energjitë në debate boshe e të pavlera. Në një epokë kur vëmendja



njerëzore është kthyer në një burim të vlefshëm dhe të limituar, mediat e porositura dhe të ndikuara nga interesa të veçanta kanë mënyrën ideale për të manipuluar perceptimin e publikut, duke e orientuar vëmendjen drejt çështjeve krejt sipërfaqësore. Në këtë situatë, qytetari nuk reagon më ndaj problemeve që e prekin realisht, pasi mendjen e tij e ka të ngarkuar tashmë me episode kalimtare, si sherret në emisionet televizive, polemikat pa lidhje me personazheve të spektaklit, apo thashethemet e jetës private të njerëzve, që në të vërtetë s'kanë asnjë ndikim në jetën reale të shumicës. Shkurt, krijohet një realitet alternativ, i cili duket argëtues, por është i zbrazët dhe pa përmbajtje. Ky realitet alternativ bëhet aq i zakonshëm sa që publiku gradualisht fillon të mendojë se kjo është norma.

## Kaosi informativ

Nëse nuk e bind dot qytetarin, atëherë ngatërroje. Kjo strategji, e njohur edhe si “firehose of falsehood”, konsiston në

publikimin masiv të informacioneve kontradiktore, shpesh krejtësisht të rreme. Qëllimi nuk është vetëm të besosh një version të caktuar të historisë, por të humbësh orientimin në atë masë që as nuk di më çfarë të besosh. Në këtë kaos, kush qëndron prapa merr kontrollin më kollaj mbi narrativën, pasi askush nuk ka më siguri mbi faktet.

## Diskreditimi

Teknikë klasike, por ende shumë efektive. Në momentin që dikush guxon të bëjë një hap para dhe të bëjë një kritikë, apo të denoncojë një padrejtësi, propaganda nuk merret me përmbajtjen e asaj që thotë. Nuk ka interes të debatojë mbi fakte, mbi logjikë apo mbi të vërtetën. Dhe fillon menjëherë sulmi personal: Kush është ky që flet? Çfarë ka bërë në të kaluarën? A ka pasur ndonjë gabim, ndonjë dobësi, ndonjë mëkat që duhet gërrmuar?

Synimi është i qartë: të zbehët besueshmëria e kritikut, të vihet në dyshim integriteti i tij, dhe të zhvendoset vëmendja nga problemi real, drejt një loje ku

dominon balta. Kështu, kush ndjek debatin nuk e kupton më për çfarë po flitet. Diskutimi nuk zhvillohet më mbi temat me interes, por shndërrohet në një dramë personale me përbaltje, insinuata dhe gjykime morale. Kjo teknikë ka një efekt të dyfishtë: nga njëra anë, frikëson njerëzit e tjerë që mund t'u shkojë mendja të flasin – askush nuk dëshiron që të bëhet shënjestër në media – dhe nga ana tjetër, i krijon publikut përshtypjen se të gjithë janë njësoj. Prandaj nuk ka kuptim të dëgjosh askënd. Rezultati? Një krizë e zgjatur besimi. Askush nuk i beson më askujt.

## Frika dhe ankthi kolektiv

Kur mes njerëzve dominon frika, ndodhin automatikisht dy fenomene të tjera: Sprapset logjika dhe mpaket shpresa. Njeriu bëhet më i prekshëm, më i manipulueshëm, më i gatshëm për të pranuar gjithçka që i serviret si “zgjidhje”. Dhe këtu ndërhyr propaganda. Është mekanizëm psikologjik i mirënjohur. Nisin e përdoren mjeshtërisht lajmet dramatike,

alarmet publike, gjuha e katastrofës. Jo për të informuar, por për të ruajtur mes njerëzve një gjendje të vazhdueshme tensioni dhe paqëndrueshmërie emocionale. Frika bëhet instrument. Dhe kur frika bëhet sistem e stresi normë, liria nuk ekziston më. Dhe ata që e kanë në duar instrumentin, janë të lirë të bëjnë ç'të duan.

Në fund të ditës, propaganda nuk synon kontrollin fizik të njerëzve. Shënjestër e saj është mendja. Propaganda nuk të urdhëron. Propaganda të bind që të bindesh.

Propaganda nuk të ndalon të mendosh, por të bën të ndjehesh sikur nuk ke pse lodhesh që të mendosh.

Dhe kur mbërrihet në pikën kur njeriu nuk pyet, nuk dyshon dhe nuk analizon më, kontrolli ka arritur përsosmërinë e vet. As me dhunë dhe as me frikë. Thjesht me një mjegull që përhapet çdo ditë nga pak, që të rrethon e të rrethon deri kur nuk je më në gjendje të dallosh se ku përfundon realiteti dhe ku nis rrëfimi. Sepse kontrolli më i fortë është ai që s'duket. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Stadiumi ‘Zahir Pajaziti’ do të rinovohet me një investim prej 1.9 milion eurosh

Podujevë, 1 gusht - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten vendimin për financimin e projektit të rinovimit të stadiumit

“Zahir Pajaziti” me një investim prej 1.9 milion eurosh. “Qeveria e Kosovës ka miratuar sot propozim/vendimin për financimin e projektit të rinovimit të stadiumit në qytetin

tonë, një projekt i shumëpritur që do të përfshijë: Mbulesën e të gjitha tribunave dhe ndriçimin e fushës sipas standardeve të UEFA-s (Kategoria 3). Faleminderit Kryeministrit Albin

Kurti, Ministrit Hajrullah Çeku dhe Qeverisë së Kosovës për këtë përkrahje të madhe për sportin në Podujevë. Urime gjithë tifozëve dhe sportistëve!”, ka shkruar Bulliqi.



## GJILANI NDAHET ME KUSHTRIM SHABANIN DHE ARAGO JAMALIN

### “Epoka e re”

**GJILAN, 1 GUSHT** - Skuadra e Superligës së Kosovës, SC Gjilani, ka njoftuar zyrtarisht largimin e dy futbollistëve të saj, Kushtrim Shabani dhe Arago Jamal. Të dy lojtarët kanë përfunduar bashkëpunimin me klubin gjilanas dhe nuk do të jenë më pjesë e ekipit në sezonin e ri. Vendimi është marrë me mirëkuptim të ndërsjellë, ndërsa klubi ka shprehur mirënjohje për angazhimin dhe kontributin e tyre gjatë kohës së qëndrimit në Gjilan. Përmes një njoftimi të publikuar në faqet zyrtare, SC Gjilani ka shprehur respekt dhe falënderime të thella për Shabanin dhe Jamalin, duke theksuar se dyert e klubit mbeten gjithmonë të hapura

për ta. “Me mirënjohje të thellë dëshirojmë të falënderojmë Kushtrim Shabanin dhe Arago Jamal për kontributin e tyre të çmuar dhe përkushtimin e vazhdueshëm ndaj klubit. Ju urojmë suksese të mëtejshme në rrugëtimin tuaj profesional dhe personal, duke e lënë gjithmonë derën e hapur për të ardhmen”, thuhet në komunikatën e klubit. Largimi i dy futbollistëve vjen në kuadër të përgatitjeve të klubit për sezonin e ri, ku priten përf forcime dhe ndryshime në përbërje. SC Gjilani është duke punuar intensivisht për të ndërtuar një skuadër konkurruese që do të synojë objektiva të mëdha në kampionatin e ardhshëm. Ndërkohë, mbetet të shihet se cili do të jetë destinacioni i radhës për Shabanin dhe Jamalin.



### Drita paraqet Kristal Abazajn

Skuadra e Dritës përmes një njoftimi në rrjetet sociale ka bërë me dije se ka transferuar futbollistin Kristal Abazaj. Abazaj, i cili ka një karrierë të shquar dhe një lojtar me mjaft përvojë, i është bashkuar kampionit të Kosovës në një marrëveshje dyvjeçare. “Një tjetër emër i madh i bashkohet skuadrës sonë. Mirë se vjen Kristal Abazaj! Jemi të lumtur të njoftojmë përf forcimin më të ri të klubit tonë Kristal Abazaj, një lojtar me eksperiencë dhe cilësi të lartë që i shtohet repartit ofensiv. Pas një angazhimi dhe vendosmërie të madhe, drejtori ynë sportiv Valon Zymberi ka arritur të mbyllë me sukses marrëveshjen që sjell Kristalin në radhët tona. Abazaj ka firmosur një kontratë dyvjeçare. Ai pritet të jetë një armë e fortë për trajnerin Ramadani”, ka njoftuar Drita.

## BERISHA ISHTE HEROI NDAJ ANDERLECHTIT, KLUBI SUEDEZ E ‘BLINDON’ DERI NË VITIN 2027



**GOTHENBURG, 1 GUSHT** - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, ka zgjatur bashkëpunimin me klubin suedez BK Hacken deri në vitin 2027. Lajmi vjen vetëm pak orë pasi Berisha luajti një rol vendimtar në kualifikimin historik të skuadrës ndaj Anderlechtit në Ligën e Evropës, si dhe pasi ndihmoi ekipin të fitonte Kupën e Suedisë në fund të muajit maj. “Ndihem shumë mirë që kam rinovuar me klubin. Gjatë këtyre muajve kemi bërë shumë gjëra të mira. Kemi një skuadër me potencial dhe mendoj se mund të arrijmë edhe më shumë në të ardhmen”, ka

thënë Berisha pas nënshkrimit të kontratës së re. Berisha, i cili iu bashkua klubit më 11 prill, ka impresionuar me paraqitjet e tij dhe shprehu kënaqësinë për përvojën e tij te klubi suedez: “Kur erdha këtu u befasova pozitivisht nga gjithçka: infrastruktura, lojtarët, stafi. Është një ambient shumë i mirë për të punuar dhe për të luajtur futboll”. Me 81 ndeshje me fanellën e Shqipërisë, portieri 35-vjeçar u shpreh se synon të vazhdojë ta ndihmojë BK Hackenin të arrijë suksese të tjera në vitet në vijim. “Këto muaj kanë qenë shumë të këndshëm. Finalja e Kupës është

momenti më i bukur deri tani. Fitorja në Kupën e Suedisë është diçka që nuk do ta harrojmë. Kur luajmë si ekip, jemi shumë të fortë. Po bëjmë ndeshje të mira dhe jemi ende në garat evropiane. Kemi shumë mundësi për të ecur përpara dhe për ta shijuar futbollin tonë”.

### Mediat turke: Rashica do të largohet nga Besiktasi

Situata te Beshiktashi është tensionuar pas eliminimit nga Shakhtar Donetsk dhe, sipas medias turke “Aksam”, Milot

Rashica pritet të jetë lojtari i parë që largohet nga skuadra. Performanca e tij e dobët në ndeshjen e parë në Stamboll dhe mungesa e aktivizimit në ndeshjen e kthimit kanë bindur trajnerin Solskjaer për largimin e tij. Tifozët e vërshtëllën Rashicën në ndeshjen e parë, ndërsa klubi i ka kërkuar tashmë të gjejë një skuadër të re. Edhe pse ai ka kontratë deri në vitin 2027 dhe vlerësohet rreth 6.5 milionë euro, pritet që ndarja të zyrtarizohet së shpejti. Ende nuk dihet se ku mund ta vazhdojë karrierën futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës.

## Kosova me 9 garues në Kupën Evropiane për Junior në Shkup 2025

**PEJË, 1 GUSHT** - Kosova do të marrë pjesë me nëntë garues në Kupën Evropiane për Junior e cila do të zhvillohet më 2 dhe 3 gusht 2025 në Shkup, Maqedonia e Veriut. Ky event i nivelit të lartë do të mbledhë 239 sportistë, 161 meshkuj dhe 78

femra nga 26 shtete dhe 2 kontinente, duke e kthyer Shkupin në një qendër të rëndësishme të xhudos evropiane për të rinj. Sipas organizatorëve, djemtë do të garojnë të shtunën (2 gusht), ndërsa vajzat do të zbresin në

tatami të dielën (3 gusht). Kjo pjesëmarrje vjen si dëshmi e vazhdimësisë së zhvillimit të xhudos në Kosovë dhe përkushtimit për ta ngritur gjeneratën e re të kampionëve në skenën evropiane dhe botërore. Nën udhëheqjen e

Majlinda Kelmendit, kampione olimpike dhe një nga figurat më të respektuara në sportin ndërkombëtar të xhudos, Kosova do të përfaqësohet nga këta garues: Estea Arifaj (-48 kg), Sidorela Dodaj (-52 kg), Laurine Gashi (-52 kg), Sara Osmani (-52



kg), Erlule Musaj (-57 kg), Enise Zijade (-57 kg), Furkan Kelmendi (-60 kg), Andi Reshitaj (-66 kg), Dion Sharapolli (-73 kg).

## Autopsia zbardh shkaqet e vdekjes së Hulk Hoganit, vuante nga leukemia

UASHINGTON, 1 GUSHT - Mediet amerikane kanë siguruar raportin e autopsisë së legjendës së wrestlingit, Hulk Hogan, pas vdekjes së tij në moshën 71-vjeçare. Hulk Hogan ndërroi jetë mëngjesin e 24 korrikut. Shërbimet e emergjencës u dërguan në banesën e tij në Clearwater, Florida, ku u përpoqën ta

rikthenin në jetë, por u shpall i vdekur në spitalin "Morton Plant". Sipas Qendrës së Shkencave Forenzike të Qarkut Pinellas, shkaku zyrtar i vdekjes së Hoganit, i cili kishte histori me fibrilacion atrial, ishte një infarkt akut i myokardit. Raporti i autopsisë zbuloi se legjenda e WWE kishte pasur edhe histori me

leukemi. Fibrilacioni atrial dhe leukemia përmenden si faktorë kontribuues në humbjen e jetës së Hoganit, që u klasifikua si vdekje natyrale. Eileen Reslen raporton se nuk kishte asnjë informacion publik që Hulk Hogan, emri i vërtetë i të cilit ishte Terry Bollea, kishte vuajtur më parë nga kanceri. Brooke Hogan, vajza e

legjendës së WWE, publikoi një mesazh duke ndarë momentet e fundit me babanë e saj. Ajo nënvizoi se "nuk pati luftë të madhe, as dramë. Vetëm biseda private dhe emocionale, që bota nuk do t'i dëgjojë kurrë. I ofrova mbështetje. I kërkoja të pushonte, por ai zgjodhi një rrugë që rrënoi shpirtin e tij".



## Hamiltoni rrëfen sezonin e vështirë te Ferrari: Një betejë e vërtetë, por nuk dorëzohem

MARANELLO, 1 GUSHT - Lewis Hamiltoni ka pranuar se sezoni i parë te Ferrari po rezulton një nga më të vështirët e karrierës së tij. Shtatë herë kampioni i botës, i cili u largua nga Mercedesi pas 12 vitesh për t'iu bashkuar ekipit italian, ende nuk ka arritur të ngjitet në podium në ndonjë garë kryesore pas 13 garash nga 24 gjithsej në sezonin 2025. Duke folur me gazetarët para Çmimit të Madh të Hungarisë, gara e fundit para pushimeve verore, Hamiltoni pranoi se ka nevojë për kohë për të pushuar dhe reflektuar: "Sezonet e fundit kanë qenë të vështira në mënyrën e tyre. Ky ka qenë, padyshim, më i intensivi nga pikëpamja e punës. Të përshtatesh në një kulturë dhe skuadër të re... jo gjithçka ka shkuar mirë, ka qenë një betejë e vërtetë. Kam nevojë të tërhiqem pak dhe të rifitoj energji, të kaloj kohë me fëmijët, të qesh, të çlirohem. Jam i sigurt që do të



ketë ca lot dhe besoj se kjo është e shëndetshme". Piloti britanik 40-vjeçar ka hasur vështirësi për ta treguar veten në ambientin e ri, duke qenë 30 pikë pas shokut të skuadrës, Charles Leclerc, i cili ka arritur tashmë pesë podiume në vitin 2025. Paraqitja më e mirë e Hamiltonit me Ferrarin ndodhi në Çmimin e Madh të Kinës, në garën e dytë të sezonit, kur ai fitoi garën Sprint dhe siguroi "pole-position"-in, por momente të tilla pozitive kanë qenë të rralla që atëherë. Pavarësisht prej rezultateve nën pritshmëri, Hamiltoni mbetet i motivuar dhe besimplotë në potencialin e

Ferrarit. "Gjithmonë jam i emocionuar për të garuar. E dua atë që bëj, më pëlqen të vesh të kuqen, e dua Ferrarin dhe besoj shumë në të. Është e vështirë ta shpjegosh. E ndieja këtë gjë edhe me skuadrën time të mëparshme. Me kohë ndërtohet një ndjenjë bashkëpunimi dhe unë e shoh atë pasion në këtë skuadër dhe e adhuroj këtë", u shpreh ai. Hamiltoni është i përkushtuar të shtyjë përpara ndryshime të brendshme në Ferrari, me synimin për t'i dhënë fund thatësirës së titujve që zgjat prej vitit 2008. "Gjithçka që dua është të kontribuoj sa më mirë që të mundem. Sigurisht që duhet ta bëj kryesisht në pistë dhe nuk po ia dal gjithmonë, por edhe jashtë saj, pas kuintave". Me gjysmën e sezonit ende përpara, Hamiltoni premton se nuk do të dorëzohet dhe do të vazhdojë të luftojë për ta rikthyer Ferrarin në majat e Formulës 1.

## Marrit Steenbergen fiton medaljen e artë në 100 m stil i lirë

AMSTERDAM, 1 GUSHT - Notarja holandeze Marrit Steenbergen shkëlqeu në mënyrë madhështore në Kampionatin Botëror të Notit "World Aquatics Championships 2025" që po zhvillohet në Singapor, duke fituar medaljen e artë në garën e 100 metrave stil i lirë për femra. 25-vjeçarja e nisi fuqishëm dhe mori avantazhin duke ruajtur ritmin deri në fund dhe duke e prekur murin me kohën 52.55 sekonda. Ajo siguroi kështu medaljen e parë të artë për Holandën në këtë kampionat. Në një garë të jashtëzakonshme ku konkurrenca ishte tejet e fortë, Mollie O'Callaghan nga Australia, kampione bote në këtë disiplinë në vitin 2023 dhe fituese e tri medaljeve të arta në Singapor këtë vit, u rendit e dyta me 52.67



sekonda. Amerikania Torri Huske, e cila po përballet me një shpërthim të gastroenteritit akut së bashku me disa bashkëkombëse të saj, udhëhoqi pas 50 metrave, por më pas humbi ritmin dhe e mbylli në vendin e tretë me kohën 52.89 sekonda. Rezultatet e kësaj gare përputhen me ato të botërorit të kaluar në Doha, por këtë herë konkurrenca ishte më e madhe dhe Steenbergen shprehu entuziazëm të jashtëzakonshëm pas fitores:

"Është thjesht e pabesueshme. Në Doha thashë: 'Ok, është çmenduri të fitosh', por tani, në këtë nivel, nuk di ç'të them, jam thjesht shumë e lumtur", tha ajo pas garës. Steenbergenu ndihmoi ekipin holandez ta fitonte medaljen e bronzit në stafetën 4x100m stil i lirë për femra disa ditë më parë, por nuk arriti të kualifikohet në finalen e 100 metrave shpinë, gara e saj e parë individuale në këtë kampionat.

### REZULTATET E GARËS 100M STIL I LIRË - FEMRA:

|                                |       |
|--------------------------------|-------|
| Marrit Steenbergen (Holandë) - | 52.55 |
| Mollie O'Callaghan (Australi)  | 52.67 |
| Torri Huske (SHBA)             | 52.89 |
| Milou Van Wijk (Holandë)       | 52.91 |
| Daria Klepikova (NAB)          | 52.98 |
| Beryl Gastaldello (Francë)     | 53.30 |
| Cheng Yujie (Kinë)             | 53.34 |

### SHKURT

#### Duka feston për Egnatian dhe Dinamon: Arritje e rëndësishme

Suksesi i dy ekipeve shqiptare në Evropë, Egnatias dhe Dinamos, mori përgëzimet edhe nga kreu i FShF-së, Armand Duka. "Kjo është një arritje e rëndësishme për futbollin shqiptar, që rrit kredibilitetin e klubeve tona dhe forcon imazhin e kampionatit tonë. Uroj që ky rrugëtim të vazhdojë edhe më tej me suksese të tjera. Ndërkohë, Vllaznia meriton respekt për paraqitjet. E eliminuar vetëm në kohën shtesë, tregoi karakter dhe garoi me dinjitet. Koha për të reflektuar dhe për t'u përgatitur për sezonin e ri, me të njëjtin pasion dhe ambicie", shkruan Duka në rrjetet sociale.

#### Portieri i Bayernit humbet djalin 6-vjeçar

Portieri i Bayern Munchenit, Sven Ulreich, ka ndarë një lajm të dhimbshëm me publikun, duke konfirmuar vdekjen e djalit të tij të vogël, Len, pas një sëmundjeje të rëndë dhe të zgjatur. Len ndërroi jetë në qershor, ndërsa lajmi u bë publik tani, për t'i shmangur spekulimet dhe për ta ruajtur qartësinë në rrethin familjar dhe publik. Ulreich, në një mesazh prekës në "Instagram", falënderoi familjen, miqtë dhe klubin Bayern Munich për mbështetjen dhe diskrecionin gjatë këtyre muajve të vështirë. Ai theksoi se bashkë me bashkëshorten Lisa dhe vajzën e tyre po përpiqen ta rifillojnë jetën hap pas hapi. Familja ka kërkuar privatësi dhe mirëkuptim nga mediet dhe opinioni publik. Bayern Munichu vazhdon të qëndrojë pranë Ulreich në këtë periudhë të dhimbshme.

#### Skrinier bëhet lojtar i Fenerbahçes

Fenerbahçe ka zyrtarizuar transferimin e mbrojtësit sllovak Milan Skriniar. Klubi turk ka arritur një marrëveshje me Paris Saint-Germainin dhe vetë lojtarin për blerjen e kartonit të plotë të qëndërmbrojtësit i cili ishte huazuar gjatë merkatos së janarit. "Mbrojtësi i kombëtares sllovake, Milan Skriniar, i cili iu bashkua ekipit tonë gjatë afatit kalimtar dimëror në formë huazimi, tashmë është pjesë e Fenerbahçes me transferim të përhershëm. Klubi ynë ka nënshkruar një kontratë katërvjeçare me lojtarin i cili do të vazhdojë t'i mbrojë ngjyrat verdheblu", thuhet në njoftimin zyrtar të klubit nga Stambolli. Fenerbahçe i uron mirëseardhje mbrojtësit me përvojë dhe i dëshiron shumë suksese në aventurën e tij të re në radhët e ekipit. Skriniar, i njohur për grintën dhe qëndrueshmërinë në prapavijë, do të jetë një përforcim i rëndësishëm për objektivat ambiciozë të klubit në kampionat dhe arenën ndërkombëtare.

## Newcastle refuzon 140 milionë euro e Liverpoolit për Isakun

Newcastle e ka refuzuar një ofertë të majme nga Liverpooli për sulmuesin suedez Alexander Isak në vlerën e 120 milionë paundëve (rreth 140 milionë euro), raporton "The Athletic". "Magpies" ka tentuar ta bindë

lojtarin të qëndrojë me një rinovim kontrate, rritje rroge dhe një klauzolë largimi për vitin 2026, ndërkohë që disa bashkëlojtarë i kanë kërkuar të mos largohet. Megjithatë, Isak ka qenë i qartë prej kohësh për

dëshirën e tij për të ndërruar ambient dhe, pavarësisht prej përpjekjeve, situata po bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar në tavolinën e negociatave. Newcastle e vlerëson kartonin e tij në 170 milionë euro, ndërsa

Liverpooli nuk është i gatshëm të shkojë përtej 120 milionë eurove. Nëse transferimi do të konkretizohet në javët e ardhshme, "Reds" do të duhet ta paguajë shifrën që kërkon Newcastle. Në atë rast, blerja e

Isakut nga Liverpooli mund të kalojë edhe transferimin e Florian Wirtz, për të cilin u shpenzuan 136 milionë euro plus bonuse, duke e bërë suedezin një nga blerjet më të shtrenjta në historinë e klubit anglez.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1229 /1  
Dt: 01.08.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

| Niveli   | Institucioni/Shkoll<br>a           | Vendi       | Pozita:                                                               | Vend i lirë/<br>Zëvendësim | Numri i<br>pozitive | Koeficient<br>i i pagës |
|----------|------------------------------------|-------------|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------|---------------------|-------------------------|
| ShM<br>L | Qendra e<br>Kompetencës<br>Ferizaj | Feriza<br>j | Një (1)<br>Mësimdhënës/<br>e për lenden<br>Ekonomi dhe<br>Ndërmarrësi | Vend i lirë                | 1                   | 6.8                     |

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI
- Certifikatat e trajnimeve
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës/e për Lëndën Ekonomi dhe Ndërmarrësi

- Msc. i ekonomisë - profili përkatës;
- Ekonomist i diplomuar - i përgjithshëm

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.

- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 01.08.2025 deri me 30.08.2025.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Pranvera Zena shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “12 Maji” Ratkoc Rahovec.

- Mëndi Quni shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës së fmu “Jah Salihu” Molliq Gjakovë.

- Rrezon Juniku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- GSH Services SH.P.K. shpall t6ë pavlefshme numrin unik identifikues 812245927 të lëshuar nga ARBK.

- Florjana Ndrecaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe certifikatën diplomën e shmm “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- D.P.H “Namiku” Rahovec shpall të pavlefshme numrin unik identifikues 810393570 të lëshuar nga ARBK.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



# TRADITË QË NGA 1992





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

